



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 05.03.2025

Nr: 11

Ora: 11:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHOYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 04, DATË 03.03.2025
TË DEPOZITUAR NGA PARTIA “ALEANCA EUROPIANE EKOLOGJIKE-AEE”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.03.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE

OBJEKT: Ndryshimin e vendimit nr. 230, datë 28.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e elementëve përmbajtësor të fletës së votimit, shpallur në seancën e datës 28.02.2025.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 04 regj., datë 03.03.2025.



Në mbledhjen e datës 05.03.2025, pas relatimit të z. Ledio Braho, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 04, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Në zbatim të nenit 145, të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurës Administrative, KAS çmon se partitë politike, mund të kenë interesit të ligjshëm si subjekte zgjedhore të regjistruara për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, prandaj duhet të njoftohen për t’u paraqitur në seancën e shqyrtimit të Kërkesës Ankimore nr. 04, datë 03.03.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 04, datë 03.03.2025, të paraqitur nga Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 07.03.2025, ora 10:30.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio BRAHO - Relator

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Illirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar